



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Diasporës
Ministarstvo za Dijasporu
Ministry of Diaspora



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVO BAR ASSOCIATION

Republika e Kosovës / Republic of Kosovo / Republika Kosova
ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
KOSOVA CHAMBER OF ADVOCATES
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
Nr. Br. 441/15
Dt. 07.07.2015
PRISHTINË - PRISTINA - PRIŠTINA

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRY OF DIASPORA / MINISTRY OF DIASPORA / MINISTARSTVO ZA DIJASPORU
Nr. Prot. 436
Broj Prot. 01
Prot. No. 04
Data: 07.04.2015
Datum: 07.04.2015
Date: 07.04.2015
Prishtinë / a

Marrëveshje bashkëpunimi

ndërmjet

Ministrisë së Diasporës

dhe

Odës së Avokatëve të Kosovës

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi (më tutje marrëveshje) ndërmjet Ministrisë së Diasporës (më tutje MeD) dhe Odës së Avokatëve të Kosovës (më tutje OAK) është bashkëpunimi në të gjitha çështjet me interes të përbashkët.

Neni 2 Përgjegjësitë e palëve

Bazuar në Ligjin nr.04/L-095 të Diasporës dhe Mërgatës, Strategjinë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018, si dhe në Planin e Veprimit për Diasporën dhe Mërgatën dhe objektivat strategjike të paraqitura në këto dokumente:

Ministria e Diasporës dhe Oda e Avokatëve të Kosovës do të bashkëpunojnë në këto fusha:

- 1) Mbrojtja e interesave të shtetasve të Republikës së Kosovës, të cilët jetojnë jashtë vendit - si kategori kushtetuese, në mënyrën më të mirë dhe të mundshme juridike.
 - 2) Koordinim të aktiviteteve, të krijuara ndërmjet rrjetëzimit të juristëve të diasporës dhe mërgatës, në funksion të njohjes me të drejtat që u takojnë në vendet ku jetojnë dhe veprojnë.
 - 3) Sensibilizimi i diasporës dhe i mërgatës për të drejtat, avancimi i të drejtave të përgjithshme, si dhe fuqizimi i bashkëpunimit me autoritetet relevante në nivel qendror, rajonal dhe lokal në vendet ku diaspora dhe mërgata e Kosovës jeton dhe vepron.
 - 4) Krijimi i mundësive në procesin e integritimit në vendet pritëse të diasporës dhe mërgatës, si dhe njohja me të drejtën në kuptim të krijimit të lehtësive për integrim.
 - 5) Krijimi i mundësive të lidhjes së marrëveshjeve ndërshtetërore mes Republikës së Kosovës dhe shteteve ku jeton dhe vepron diaspora e mërgata, në kuptim të integritimit të saj.
 - 6) Krijimi i kontakteve nëpërmjet rrjetëzimit të juristëve me diasporën dhe mërgatën, njohja me problemet dhe vështirësitë e zgjidhjes së tyre në vendet ku jetojnë dhe veprojnë, mundësitë e përfaqësimit në institucionet pritëse dhe njohja me të drejtat e tyre.
 - 7) Publikimet e broshurave dhe materialeve të tjera informuese, shpërndarja e tyre nëpërmjet rrjetëzimit të juristëve, vetëdijesimi i diasporës e i mërgatës për
-

procesin e integritit me rregullat normative dhe sociale në shtetet ku jetojnë dhe veprojnë.

- 8) Sigurimi i resurseve humane profesionale nga të dyja subjektet e kësaj marrëveshjeje lidhur me njohjen e të drejtave nga fusha të ndryshme juridike dhe kontributi i tyre në procesin e implementimit të projekteve konkrete, të cilat do të bëhen në vende të ndryshme, ku numri i pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës është më i theksuar.
- 9) Njohja me të drejtat, të cilat janë të parashikuara me legjislacionin e vendit amë, si dhe krijimi i lehtësive juridike lidhur me realizimin e atyre të drejtave.

Neni 3

Format e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi ndërmjet MeD-së dhe OAK-së do të ndërtohet mbi bazën e kërkesave nga të dyja palët e kësaj marrëveshjeje. Kërkesat do të bëhen transparente për subjektet e marrëveshjes sipas përgjegjësive të parashikuara me këtë marrëveshje bashkëpunimi.

2. Palët e kësaj marrëveshjeje, brenda përgjegjësive të parashikuara me këtë marrëveshje, do të ndihmohen si në aspektin e projektimit të projekteve konkrete, po ashtu edhe në implementimin e tyre.

3. Lidhur me specifikimet e paraqitura në bazë të projekteve konkrete, palët e kësaj marrëveshjeje do të krijojnë lidhje kontaktuese dhe takime sipas nevojave të paraqitura.

4. Realizimi i takimeve (tryezave) të ndryshme dhe krijimi i mundësive të informimit publik lidhur me këto takime, të natyrave të ndryshme të bashkëpunimit, sipas përgjegjësive që dalin nga kjo marrëveshje.

5. Bërja transparente e aktiviteteve të ushtruara nga palët e kësaj marrëveshjeje për projektet që implementohen bashkërisht sipas përgjegjësive të parashikuara në këtë marrëveshje.

Neni 4

Detyrimet financiare

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit nuk do të nënkuptohet si krijim i ndonjë detyrimi financiar ndërmjet subjekteve të marrëveshjes.

Neni 5

Kohëzgjatja dhe modifikimi i marrëveshjes


- 1.Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.
- 2.Nëse ndonjëra nga dy palët konsideron se kjo marrëveshje duhet të amendamentohet, atëherë mund të kërkojë konsultime me Palën tjetër. Çdo ndryshim i këtij memorandumi mund të bëhet me marrëveshje reciproke.
- 3.Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, duke vepruar në emër të institucioneve përkatëse nënshkruan këtë Marrëveshje në dy kopje origjinale.

Për Ministrinë e Diasporës


Valon Murati
Ministër i MeD-së



Për Odën e Avokatëve të Kosovës


Ibrahim Dobruna
Kryetar i OAK-së